

Naxhi Selimi

Bazat e integritit parashkollor



ISEAL

Mbështetur nga :



*Soutenu par le Bureau
cantonal pour
l'intégration des
étrangers et la prévention
du racisme (BCI)*



Ville de Moudon



Commune d'Avenches

Bazat e integritit parashkollor



Falënderime të veçanta personave që kanë mbështetur këtë projekt:

- o Znj. Amina Benkais, shefe e BCI-së e kantonit Vaud
- o Znj. Anne Rodi, mësimdhënëse në SHLP-Lozanë (Shkolla e Lartë Pedagogjike), përgjegjëse e projektit SPS në Shqipëri
- o Prof. Dr. Basil Schader, mësimdhënës në SHLP të Zurich-ut
- o Z. Labinot Hasani, informatikë
- o Znj. Lucy Clavel Raemy, mësimdhënëse në SHLP-Lozanë
- o Znj. Martine Jaquier, mësimdhënëse në shkollën Léon-Michaud (Yverdon-les-Bains)
- o Prof. Dr. Nerimane Kamberi, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, përgjegjëse e programit Master Përkthim dhe Interpretim
- o Z. Rexhep Rifati, gazetar
- o Z. Sulejman Dërmaku, redaktor gjuhësor në shqip



TABELA E PËRMBAJTJES

o	Driton Kajtazi: Parathënie	7
o	Naxhi Selimi: Familja si shtyllë kryesore e fëmijës	11
o	ISEAL-i ju sugjeron referencat e integritit	47



PËR NJË PJEKURI TË INTEGRIMIT TË MOSHËS PARASHKOLLORE

Vitet e para të jetës lënë gjurmë përgjithmonë. Nëse mungojnë këto piketime nga fëmijëria e hershme, secila shoqëri ndoshta do të duhej të mendonte për të ardhmen e vet.

Diaspora shqiptare është njëra nga më të rejat dhe më të mëdhatë në Zvicër. Këta fëmijë, të lindur në Zvicër, nesër do të jenë qytetarë të devotshëm të këtij vendi, i cili dikur i mirëpriti prindërit e tyre. Këta fëmijë nuk do të jenë barrë, por ata do të jenë peshë e Zvicrës.

Prindërit e tyre në Zvicër kanë ardhur në kushte shpesh të pavolitshme, për shkak të vështirësive në vendin e tyre të prejardhjes (luftërat, situata socio-ekonomike jostabile, papunësia e lartë, shkollimi ndonjëherë i pafulluar apo i ndërprerë, ndarja nga familja, situata rreth statusit të tyre si emigrantë shpesh jo e rregulluar etj.). Dhe, "një udhëtim njëkohësisht shënjohej në hapësirë, në kohë dhe në hierarkinë sociale", siç e thoshte Claude Levi-Strauss.

Prindërit gjenden, me zemër të ndarë, midis dashurisë ndaj vendit të tyre dhe ngulmimeve në vendin që i mirëpret. Isabelle Alonso, në *Mërgimi është vendi im*, shkruan: "Kujtesa është i vetmi territor i emigrantëve". Prindërit me vete sjellin kujtimin dhe dashurinë për vendlindjen e tyre. Pikërisht kjo dashuri për atdheun, na shtyn ta duam vendin që na ka mirëpritur.

Mbajtja e lidhjeve me vendlindjen dhe me familjarët, dikur, në fillim të shekullit të kaluar (XX), ishte një ndër-marrje plot pengesa. Të kthenin faqen e të shkruanin një kapitull të ri, madje edhe përmes asimilimit, që shpeshherë i ngjante integrimin amnezik, shpesh ishte zgjidhje e vetme për emigrantët. Sot, zhvillimi i shkencës, i mjeteve të komunikimit (interneti, telefoni, media), i mjeteve të transportit si dhe i udhëtimit kanë ecur shumë përpara. Kontaktet me familjen dhe me vendlindjen për emigrantët janë shumë më të lehta, gjë kjo që edhe vendet ku ata emigrojnë i bën të jenë më të hapura dhe më të ndjeshme ndaj kujtesës së tyre.

Emigranti dhe shoqëria mikpritëse sot vënë përpara një integrim të plotë, në integritet e tërësi. Shkolla, shoqëria mikpritëse dhe familja, shtylla të kohezionit shoqëror, kështu, bashkërisht, "përplasjen kulturore" e shndërrojnë në një "përplasje të kulturuar".

Në këtë drejtim, Naxhi Selimi na e sjell këtu një tekst, i cili, në thjeshtësinë e tij, ka një thellësi aq bukur të kristalizuar në fjalën e urtë shqipe: *Sa më i thellë lumi, aq më i qetë*. Një qetësi që i ngjan fuqisë së qetë të Zvicrës, një qetësi e ndriçuar nga thellimi i njohjes sonë të ndërsjellë, nga kuptimi ynë i përbashkët.

Ky projekt nuk i drejtohet vetëm një bashkësie të veçantë kombëtare, por i drejtohet një të vetmit fëmijë. Një fëmijë, pavarësisht nga vijnë prindërit e tij, do ta njohë veten në këtë tekst, do ta kuptojë këtë tekst, sepse fëmijët nga të gjitha anët e rruzullit tokësor e kuptojnë njëri-tjetrin. Nëse "populli është një rezervuar i pafajësisë", siç thoshte shkrimtari zviceran Ramuz, fëmijëria është "minierë" e kuptimit. Janë të rriturit ata që fëmijëve mund t'ua mësojnë moskuptimin.

ISEAL me gëzim fëmijëror nis botimin e tij të parë, simbolikisht, me këtë temë që prek moshën parashkollore, themelet e jetës, në mënyrë që e ardhmja të ketë një prani të tanishme.

Driton Kajtazi
Drejtor i ISEAL



© BETOGJENI

*« Këta fëmijë, të lindur në Zvicër,
nesër do të jenë qytetarë të
devotshëm të këtij vendi,
i cili dikur i mirëpriti prindërit e tyre.
Këta fëmijë nuk do të jenë
barrë, por ata do të jenë
peshë e Zvicrës. »*



FAMILJA SI SHTYLLË KRYESORE E FËMIJËS

Hyrje

Në gazeta e revista shpesh shkruhet për rëndësinë e përkrahjes së fëmijës në moshën më të re. Në fokus të debatit është përpjekja e institucioneve për t'u ofruar të gjithë fëmijëve shanse të njëjta, pavarësisht nga gjendja familjare, sociale dhe ekonomike. Mirëpo, nga ana tjetër, shkruhet shumë pak se ç'nënkuptohej me «shanse të njëjta» dhe konkretisht për cilat «shanse» është fjala? Me këtë lidhet ngushtë pyetja tjetër: Kush sa mund të veprojë dhe të ndikojë në arritjen e shanseve të tilla?

Veçanërisht duhen përmendur dy aspekte: Qarqet profesionale nëpër institucione të ndryshme në fokus të vëmendjes dhe të përpjekjeve kanë suksesin e mëvonshëm arsimor të fëmijës, kur flasim për shanset. Sipas tyre, çdo fëmije duhet t'i mundësohet të zhvillojë aftësitë dhe potencialet e tij, pavarësisht nga gjendja familjare.

Nga ana tjetër, nuk është e qartë se si e parashohin prindërit këtë gjë. A pajtohen ata me mendimet e qarqeve profesionale? Si duket, një pjesë e prindërve nuk duan t'i japin fëmijës që në vitin e parë të jetës së tij «obligime për të mësuar», siç shprehen disa prindër. Njëkohësisht, ka prindër me status të mesëm dhe të lartë ekonomik, të cilët fëmijës së tyre që në moshën më të re i ofrojnë mundësi për të ndjekur kurse të cilësisë së lartë. Kjo situatë vë në dukje kundërthënien ndërmjet qëndrimit dhe veprimit të institucioneve edukative, të cilat nuk lodhen së foluri për rëndësinë e përkrahjes së një fëmije që t'i zhvillojë aftësitë e tij, kurse, nga ana tjetër, nuk ofrojnë mundësi të mjaftueshme dhe konkrete nga të cilat do të përfitonin të gjithë fëmijët (pra, edhe ata që rriten në familje me status të ulët social ose ekonomik). Deri tash nuk është gjetur ende ndonjë model i suksesshëm, i cili do të mundësonte shanset për të cilat flitet shumë e realizohen aq pak.

Parakushti për lehtësimin e jetës së përditshme në vendin mikpritës në mërgatë

Si parakusht për lehtësimin e përditshmërisë dhe inkuadrimit në shoqëri pa dyshim është njohja e gjuhës që flitet në mërgatë. Kjo kompetencë prindërve dhe fëmijës ua lehtëson njohjen e normave të rrethit ku jetojnë, si, për shembull: mënyrën e të përshëndeturit, lartësinë e zërit gjatë bisedës, distancën fizike nga bashkëbiseduesit, sqarimin e moskuptimeve eventuale etj. Në lidhje me këtë duhet të theksohet se në ballafaqim me gjuhën dhe kulturën e re duhet të mbahet qëndrim pozitiv, pa marrë parasysh nëse janë të njëjta apo të ndryshme kundruall bindjeve dhe orientimeve kulturore e gjuhësore të vendlindjes së prindërve. Pra, bindjet gjuhësore të prindërve ndikojnë drejtpërdrejt në sjelljen gjuhësore të fëmijës. Mu për këtë tepër e rëndësishme është që prindërit fëmijës t'ia shprehin qëndrimin e tyre pozitiv ndaj gjuhës dhe kulturës amtare si dhe ndaj atyre lokale në mërgatë. Kështufëmijës i lehtësohet ballafaqimi i përditshëm me këto dy gjuhë dhe i ngrihet vetësiguria gjuhësore në të dy gjuhët.

Nëpërmjet kontakteve ofrohen mundësi të reja për të njohur dhe për të krahasuar vlerat materiale dhe morale të vendlindjes me ato të vendit mikpritës.

Një ballafaqim i tillë jo vetëm që mundëson njohjen e gjuhës dhe të kulturës së rrethit të ri, por fëmijës ia ngre vetëdijen për rëndësinë e vlerave dhe normave që i praktikon në familje.

Familja si shtyllë kryesore e fëmijës

Familja paraqet instancën më të rëndësishme për zhvillimin dhe socializimin e fëmijës. Ajo i ofron fëmijës dashuri, edukatë dhe siguri emocionale. Kjo bazë themelore është vendimtare për zhvillimin e fëmijës dhe për suksesin e tij të mëvonshëm në arsim, në profesion dhe në jetë.

Pavarësisht faktit nëse janë prindërit të arsimuar ose jo, ata duhet të kenë besim në fëmijën e tyre dhe ta ndjekin tërë procesin zhvillimor dhe mësimor. Tepër e rëndësishme është që të mos izoloohen sidomos prindërit që nuk e njohin ende sa duhet gjuhën dhe sistemin arsimor të rrethit ku punojnë dhe qëndrojnë. Përkundrazi, ata duhet të interesohen për shëndetin dhe për zhvillimin gjuhësor të fëmijës së tyre dhe ta përkrahin atë konkretisht. Si aktivitete me vlerë të lartë për zhvillimin e fëmijës në familje dhe jashtë saj dallohen:

- o prindërit luajnë me fëmijën në banjë ose në pishinë,
- o e angazhojnë në kuzhinë, gjatë gatimit,
- o ia mundësojnë që ta dekorojë tavolinën e bukës,
- o bëjnë dialogë gjatë luajtjes me lodra,
- o luajnë lojëra të ndryshme me fëmijën,
- o nuk e lejojnë fëmijën të qëndrojë me orë të tëra para kompjuterit duke luajtur lojëra të papërshtatshme për moshën e tij,

-
- o këndojnë së bashku dhe u bien instrumenteve, si, për shembull, ksilofonit për fëmijë etj.,
 - o u rrëfejnë tregime dhe përralla që i përshtaten moshës së fëmijës,
 - o dalin në natyrë, ku fëmija ka mundësi të shohë kafshë,
 - o gjatë shëtitjes e trimërojnë fëmijën që të ecë, pa e bartur mbi supe ose pa e shtyrë me karrocën për fëmijë,
 - o shkojnë në muze për fëmijë ose në kopsht zoologjik,
 - o ftojnë fëmijë të tjerë për të luajtur ose gjatë festimit të ditëlindjes,
 - o zhvillojnë aktivitete të tjera me familje fqinje,
 - o së bashku me fëmijën zhvillojnë aktivitete sportive (p.sh., në ndonjë shoqatë sportive të vendbanimit),
 - o e trimërojnë fëmijën që të vishet e të mbathet pa ndihmë të prindërve,
 - o shkojnë në ndonjë vend loje, ku fëmija mund të luajë me prindërit ose me fëmijë të tjerë,
 - o shkojnë me fëmijën në ndonjë kor muzikor ose në shfaqje muzikore etj.

Ndikimi i rrethit të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin e fëmijës

Fëmija i moshës më të re nuk është qenie e cila formohet apo edukohet sipas qejfit të të rriturve. Përkundrazi, ai është shumë aktiv dhe në mënyrë të pavarur i përpunon sinjalet që ia ofron mjedisi që e rrethon. Këto sinjale i sistemon e i kategorizon para se të fillojë të flasë. Megjithatë, fëmija këtë do ta arrijë shumë më lehtë nëse prindërit aty për aty i emërtojnë gjësendet që i hasin. Në këtë mënyrë fëmija i përsërit emrat e këtyre gjësendeve dhe i përforcon ata në thesarin e tij leksikor.

Në vitet e para të jetës së tij fëmija është spontan dhe i çiltër ndaj çdo gjëje. Ai është qenie sociale, jeta e të cilit është e lidhur ngushtë me jetën e njerëzve të tjerë përreth tij. Një pjesë e madhe e zhvillimit të fëmijës ndikohet nga :

- interaksioni i drejtpërdrejtë me moshatarë apo me të rritur,
- dallimet që krijohen nga trajtimi i prindërve,
- ndikimet e ndryshme nga përvojat e njëjta dhe
- faktorë të tjerë shëndetësorë të fëmijës.

Kushtet socio-kulturore luajnë rol të rëndësishëm mbi procesin mësimor të fëmijës. Në kuadër të këtyre kushteve, fëmija zhvillohet dhe mëson individualisht. Ndryshimet individuale më së miri vërehen te fëmijët që lindin e rriten në të njëjtën familje. Rrethanat e caktuara në të cilat rritet fëmija paraqesin një faktor tjetër të rëndësishëm që mund të ndikojë mbi procesin e zhvillimit të tij. Që nga lindja, fëmija përgjithësisht interesohet për mjedisin që e rrethon. Gjatë fazës së parë të jetës, mbi interesin universal të foshnjës dhe të fëmijës së moshës më të re, në radhë të parë ndikojnë prindërit.

Gjatë bisedës (interaksionit) ndërmjet prindërve dhe fëmijës, këtij i lind një lloj interesimi për të komunikuar. Prindërit mund t'ia ngrenë fëmijës interesin ndaj gjuhës apo ndaj lojërave nëse e motivojnë atë gjatë përsëritjes së emërtimit të gjësendeve ose lojërave. Mbi të gjitha, me rëndësi është që të përsëriten dhe të aktivizohen gjërat e njëjta në kontekste të shumëllojshme. Fëmija kështu në memorien e tij i përforcon gjërat e mësuara dhe me kalimin e kohës i përdor ato në mënyrë aktive dhe të automatizuar.

Loja si burim kryesor për të mësuar gjuhën

Me kureshtjen e tij të veçantë, fëmija e zbulon gjuhën nëpërmjet lojës dhe eksperimentimit me gjësendet e mjedisit që e rrethon. Sa më të shumta që të jenë mundësitë për të zbuluar botën përreth dhe sa më të llojllojshme që të jenë stimulimet, aq më pozitiv do të jetë ndikimi i tyre mbi procesin gjuhësor, intelektual, social dhe fizik të fëmijës. Zhvillimi i këtyre aftësive është edhe më i efektshëm nëse fëmija ndihet i sigurt dhe i kënaqur në botën e lojës së tij.

Pra, fëmija i moshës më të re ka nevojë për rrethana stimuluese, të cilat i ofrojnë mundësi për aktivitete dhe për përkrahje adekuate gjatë zhvillimit të tij. Krahas kësaj, fëmija i përforcon fjalët e mësuara dhe njëkohësisht në vazhdimësi zhvillon dituritë e tij. Nëse prindërit, fjala vjen, përpiqen t'ia mësojnë fëmijës dyvjeçar fjalën «kullë» duke e përshkruar këtë në mënyrë abstrakte (p.sh., kulla është objekt ndërtimor që mund të ngrihet me material guri, druri, hekuri, betoni etj.), atëherë, nga ky lloj përshkrimi, fëmija do ta ketë të vështirë të kuptojë domethënien «kullë». Të njëjtën fjalë mund ta mësojë më lehtë, nëse gjatë lojës me figura plastike (lego) ose druri e ndërton disa herë kullën dhe përsëri e prish. Kështu, në vetëdijen e tij shfaqet dhe përforcohen fjala dhe koncepti «kullë». Ky shembull tregon se fëmija i moshës më të re më lehtë mund t'i mësojë fjalët nëpërmjet aktiviteteve dhe duke i aktivizuar të gjitha shqisat e tij. Fëmija, kështu aktivitetin, pra lojën aktuale, e shoqëron me monologë dhe njëkohësisht i përforcon fjalët që i dëgjon nga të rriturit. Në situata të tilla për fëmijën tepër motivues do të jetë fakti nëse prindërit e lavdërojnë dhe e trimërojnë atë ta përdorë fjalën dhe të mësojë fjalë të reja.





© Rexhep Rifati

*« Fëmija e moshës më të re
nuk është qenie e cila formohet
sipas qejfit të të rriturve.»*



Të mësuarit e gjuhës në moshën më të re fëmijërore

Fëmija gjuhën e mëson jashtëzakonisht shpejt dhe lehtë. Gjuha në mënyrë tejet dinamike zhvillohet sidomos në pesë vjetët e parë të jetës së çdo individi. Në moshën katër vjeç fëmija ka, për shembull, një fond prej afro 2.000 fjalësh dhe i zotëron strukturat elementare gjuhësore. Në moshën parashkollore fëmija ka një fjalor aktiv (produktiv) prej afro 4.000 fjalësh. Fjalori pasiv (receptiv) i tij është i dyfishtë. Pasuria leksikore e fëmijës rritet gradualisht.

Sidomos këta faktorë luajnë rol të rëndësishëm:

- fëmija që nga lindja ka aftësi gjuhësore,
- interaksioni social dhe mjedisi drejtpërdrejt ndikojnë në të mësuarit e gjuhës,
- në masë të duhur po ashtu ndikon raporti mes faktorëve gjenetikë e biologjikë, nga njëra anë, dhe situata individuale e familjare e fëmijës, nga ana tjetër.

Të mësuarit e gjuhës varet prej faktorëve të ndryshëm (si, p.sh., njohja, interaksioni, motorika, lidhja emocionale etj.). Nëpërmjet kontaktit të fëmijës me individë dhe me gjësende nga rrethi i drejtpërdrejtë, ai fillon ta zbulojë dhe ta mësojë gjuhën që në vitet e para të jetës së tij. Kështu fillon të mësuarit e gjuhës: për shembull, thërritja e prindërve, pyetjet dhe komentet e tyre tashmë nuk paraqesin vetëm «muzikë shoqëruese dhe përkëdhelëse», por shndërrohen në fjalë, të cilat përdoren nga personat përreth dhe kanë domethënie të caktuar.

Të mësuarit e gjuhës së dytë të vendbanimit në mërgatë

Përveç asaj që u tha më lart, në të mësuarit e gjuhës së fëmijës që socializohet në dy apo më tepër gjuhë dhe kultura ndikojnë disa faktorë të tjerë, siç janë:

- o distanca sociale dhe kulturore mes gjuhës amtare dhe gjuhës lokale,
- o prestigji dhe mirësjellja e rrethit lokal ndaj gjuhës amtare të fëmijës,
- o siguria emocionale e fëmijës dhe integrimi personal e i familjes së tij në shoqërinë e rrethit ku jeton.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është raporti i prindërve ndaj gjuhës amtare dhe gjuhës së vendit ku jetojnë. Nëse prindërit kanë qëndrim pozitiv ndaj të dyja gjuhëve dhe kulturave, atëherë fëmija mund të ndihet i kënaqur dhe i çiltër si ndaj gjuhës dhe kulturës amtare, ashtu edhe ndaj asaj të vendbanimit të tij në mërgatë.

Fazat e të mësuarit të gjuhës së dytë

Fëmija i mëson gjuhët në faza të ndryshme gjatë një procesi shumë të gjatë. Në këtë proces ndikojnë faktorë të ndryshëm, prandaj është me rëndësi që procesi i të mësuarit të jetë sa më kontekstual, heterogjen, asociativ dhe t'i përgjigjet realitetit të fëmijës. Sa më herët që t'i mundësohet atij të ballafaqohet me gjuhët, aq më mirë dhe aq më lehtë do ta ketë më vonë të mësojë gjuhë të tjera dhe të ketë sukses gjatë tërë procesit mësimor. Ky fakt dëshmon rëndësinë dhe domosdoshmërinë e dërgimit në çerdhe apo në grupe lojërash të fëmijëve të vegjël.

Kontaktet e hershme me gjuhën lokale, fëmijës i hapin perspektiva të reja dhe ia mundësojnë që gjuhën amtare ta lidhë me atë lokale dhe kështu të begatojë fondin e tij të fjalësit që në moshën parashkollore.

Përdorimi i gjuhëve në jetën e përditshme

Siç u tha më lart, fëmija i moshës më të re është tepër kureshtar. Ai pyet si quhen gjërat dhe në mënyrë spontane bën krahasimin mes tyre. Nëse, për shembull, nuk e kupton ndonjë fjalë në gjuhën amtare, ose në atë lokale, ai pyet si quhet gjësendi në njërën apo në gjuhën tjetër. Interesant është të vëzhgosh kur fëmija sqaron së pari diçka në gjuhën amtare dhe pastaj edhe në gjuhën e vendit ku jeton. Në raste të tilla ndodh që fëmija prindit t'i drejtohet duke e pyetur se si quhet diçka në gjuhën lokale dhe njëkohësisht vetë të japë përgjigjen me plot krenari.

Nëpërmjet këtyre krahasimeve gjuhësore fëmijës i ngrihet vetëdija gjuhësore dhe ai i lidh ato në një lloj rrjeti të dyfishtë.

Kohëzgjatja për të mësuar gjuhën e vendbanimit

Sa shpejt apo sa ngadalë do ta mësojë fëmija gjuhën e rrethit ku jeton varet nga prirja e tij individuale, nga interaksioni, nga aktivitetet të cilat stimulojnë nisma për të folur, nga hapësira për të komunikuar, nga mundësitë për të marrë pjesë në lojëra me moshatarë dhe me të rritur, nga lloji i lojërave, nga ndërtimi i ndonjë figure etj. Fëmija i moshës parashkollore, si zakonisht, është shumë i gatshëm për të mësuar gjëra të reja dhe pyet me kureshtje se si quhen gjësendet, bën krahasime mes fjalëve që ai i përdor në gjuhën amtare dhe në gjuhën lokale, edhe pse mund të zgjasë shumë kohë derisa t'i përforcojë fjalët në memorien e tij afatgjatë.

Për fëmijën që ka lindur dhe rritet në mërgatë, më se normale është që, varësisht nga intensiteti me të dyja gjuhët, në ndonjë temë më tepër të përdorë fjalë në gjuhën amtare, kurse në ndonjë temë tjetër më tepër fjalë në gjuhën lokale të mërgatës. Kjo është krejtësisht normale, prandaj është me rëndësi që prindërit ta trimërojnë fëmijën që të ballafaqohet me të dy gjuhët. Mu për këtë arsye të përshtatshëm janë sidomos librat dygjuhësh me ilustrime për fëmijë.

Prindërit mund të blejnë libra në gjuhën amtare gjatë pushimeve në vendlindje ose t'i huazojnë ato në ndonjë bibliotekë ndërkulturore në vendbanimin në mërgatë. Bibliotekat ndërkulturore huazojnë libra dygjuhësh me ilustrime për fëmijë të vegjël. Kështu, fëmija ka mundësi që të krahasojë fjalët e të dy gjuhëve dhe shkallë-shkallë t'i përforcojë ato.

E gjithë kjo që u tha më lart mund të shpejtojë ose të ngadalësojë të mësuarit e njëres apo të gjuhës tjetër. Kjo është krejtësisht normale për fëmijën që socializohet në dy a më tepër gjuhë. Të mësuarit e gjuhës duhet të konsiderohet si proces afatgjatë, tërëjetësor.





*« Ndodh që fëmija t'i drejtohet
prindit duke e pyetur se si quhet
diçka në gjuhën lokale dhe
njëkohësisht vetë të japë
përgjigjen me plot krenari.»*



Njohja e gjuhës dhe e kulturës së vendit mikpritës dhe ruajtja e gjuhës dhe e kulturës së të parëve

Fëmijës duhet t'i mundësohet që ta njohë dhe ta ruajë gjuhën dhe kulturën e prindërve dhe të të parëve të tij, por edhe ta mësojë e ta njohë edhe gjuhën e vendit ku jeton dhe rritet. Kështu mësohet fëmija të ketë qëndrim pozitiv ndaj gjuhëve dhe t'i konsiderojë kompetencat gjuhësore si të vlefshme.

Për t'i ruajtur këto vlera, prindërit në mërgatë duhet:

- së bashku me fëmijën të vizitojnë shfaqje kulturore që organizohen nga shoqatat dhe konsullatat e vendlindjes,
- ta dërgojnë fëmijën në kore muzikore,
- ta dërgojnë fëmijën sa më herët në kurse të gjuhës amtare për ta mësuar kështu gjuhën standarde, e cila u ndihmon më vonë, së bashku me të të vizitojnë galeri ku fëmija mund të pikturojë ose
- të shkojnë në punishte apo në festa të vendbanimit ose të ndonjë vendi fqinj.

Fjala është për aktivitete të cilat mund të fillohen dhe të realizohen nga vetë prindërit, ose në bashkëpunim me edukatorët e institucioneve prarashkollore (p.sh., grupe lojërash për fëmijë ose çerdhe). Aktivitetet e tilla njëkohësisht paraqesin forma të volitshme për zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe sociale të fëmijës. Përveç kësaj, fëmija që në moshën më të re, nëpërmjet kontakteve të ndryshme, njeh gjuhë dhe kultura të ndryshme, që ndikon pozitivisht në njohuritë e tij.

Gjuha amtare si bazë për të mësuar gjuhë të tjera

Njohuritë solide të gjuhës amtare fëmijës ia lehtësojnë të mësuarit e gjuhës së vendit ku jeton, kurse më vonë edhe të mësuarit e gjuhëve të tjera të huaja. Sidomos në moshën e re fëmijërore, në të cilën vihet themeli i formimit gjuhësor, ky formim zhvillohet nëpërmjet bisedave mes prindërve dhe fëmijës, nëpërmjet lojërave që lidhen me gjuhën, si dhe nëpërmjet stimulimeve të tjera të llojllojshme, të cilat ndihmojnë zgjerimin e fjalësit, në përgjithësi, dhe fitimin e aftësive për të komunikuar, në veçanti. Pra, nëpërmjet interaksionit dhe aktiviteteve të shumëllojshme, fëmija inkurajohet t'i përsosë aftësitë e tij gjuhësore dhe ta zbulojë begatinë gjuhësore.

Gjuhën e tij amtare fëmija e mëson në familje, edhe pse shpeshherë vetëm në trajtën dialektore dhe gojore. Mu për këtë arsye zhvillimi fizik, emocional dhe intelektual i fëmijës qëndron në raport të ngushtë me gjuhën e tij amtare. Nga kjo rezulton fakti se, nëse prindërit komunikojnë shpesh me fëmijën dhe e përdorin gjuhën amtare në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për fëmijën ose u përgjigjen pyetjeve të fëmijës duke ia sqaruar gjësendet me durim dhe fjalë të buta, më shumë vetësiguri do ketë fëmija.

Rekomandohet që prindërit të përdorin gjuhën e tyre amtare, sepse kështu do t'i ndihmohet fëmijës. Është kontraproduktive nëse prindërit, duke menduar se është më mirë të flasin me fëmijën e tyre gjuhën e vendit mikpritës, komunikojnë me fëmijën në këtë gjuhë, të cilën as vetë nuk e zotërojnë si duhet.

Duke e përkrahur dhe duke e inkurajuar fëmijën të flasë gjuhën amtare, atij i rritet vetëdija gjuhësore dhe i përforcohet identiteti i tij kulturor.

Përkrahja e fëmijës për t'i shfrytëzuar aftësitë e tij

Duke ndërmarrë prindërit aktivitete të ndryshme me fëmijën në shtëpi, njëkohësisht hollësisht do t'i njohin aftësitë dhe të metat e fëmijës dhe do ta përkrahin fëmijën që dobësitë t'i shndërrojë në aftësi. Sa më mirë që t'i njohin prindërit aftësitë dhe dobësitë e fëmijës, aq më hollësisht mund t'ia përshkruajnë këto edukatores, e cila, sipas informatave të prindërve, do të përfitojë një pasqyrë të qartë për fëmijën. Këto njohuri ia mundësojnë ta përkrahë fëmijën në mënyrë të përshtatshme dhe pikërisht në ato tema apo lojëra, të cilat i ka qejf fëmija.

Kështu që në fillim fëmijës i ofrohet ndihmë adekuate për t'i shndërruar dobësitë e mundshme në aftësi dhe për t'i përballuar sfidat dhe vështirësitë e përditshmërisë, si në institucion (p.sh., në çerdhe, në grup loje, në familje ditore etj.). Natyrisht që kjo përkrahje e prindërve nuk mund të kuptohet si përpjekje për të marrë përsipër përgjegjësinë e fëmijës për të mësuar që të mendojë dhe të veprojë. Përkundrazi, qëllimi është që fëmija të aftësohet të mbartë vetë përgjegjësitë dhe të krijojë ardhmëri sa më të mirë.





© BETOGJENI

« Me rëndësi të madhe janë institucionet jashtëfamiljare, sepse fëmijët e moshës së re mësojnë shpejt dhe i formojnë kompetencat e tyre themelore, siç janë: perceptimi, fantazia, të menduarit, afërsia sociale si dhe shkathtësia trupore.»



Rëndësia e raportit të fëmijës me prindërit dhe me edukatoren

Raporti i mirë i fëmijës me prindërit dhe edukatoren ndikon që ai të ndihet i kënaqur. Mu për këtë arsye është shumë me rëndësi që prindërit dhe edukatorja ta përmbushin rolin e tyre edukativ dhe ta nxisin fëmijën që t'i përforcojë dhe t'i zgjerojë aftësitë gjuhësore dhe sociale. Kjo arrihet, kur fëmija ka mundësi të vizitojë vende të volitshme për të fituar përvojë, si, për shembull:

- o kopshtin zoologjik për fëmijë,
- o teatrin e fëmijëve,
- o vende të përshtatshme në natyrë,
- o bibliotekat për fëmijë, si dhe
- o vende të tjera atraktive që e vlen të vizitohen.

Kjo vlen sidomos atëherë, kur kushtet e banimit nuk ofrojnë mundësi për frymëzime dhe përjetime të volitshme për fëmijën.

Bashkëpunimi i prindërve me edukatoren e fëmijës së tyre

Një ndër veçoritë më të rëndësishme të një bashkëpunimi të frytshëm të prindërve me edukatoren e fëmijës është kur komunikimi mes tyre nuk kufizohet ose nuk reduktohet në informata dhe situata të rastit dhe sipërfaqësore për fëmijën, por zhvillohet në mënyrë partneriteti dhe është transparent.

Një bashkëpunim i tillë nuk bën të reduktohet vetëm në dorëzimin e ndonjë fletushke informative, e cila, për shkaqe gjuhësore, ndoshta nuk kuptohet ose nuk lexohet fare. Përkundrazi, prindërit duhet:

- të kërkojnë biseda, me ç'rast mund të flasin mbi zhvillimin gjuhësor dhe social të fëmijës,
- të pyesin për shembuj konkretë dhe forma të ndryshme të cilat praktikohen në çerdhe apo në grup loje dhe të cilat mund të praktikohen nga prindërit në familje,
- të ofrojnë shembuj dhe ide të veta, të cilat do të zgjojnë interes te fëmija, do t'u përgjigjen preferencave të fëmijës etj.

Hapa të këtillë jokonvencionalë janë të vlefshëm në radhë të parë për fëmijën, kurse më pastaj edhe për prindërit dhe për edukatoren. Pjesëmarrja aktive e prindërve në proceset mësimore dhe edukative pa dyshim paraqet një ndihmesë të rëndësishme dhe të frytshme për fëmijën. Prandaj, ndihmesa e tillë gjithsesi e vlen që të shfrytëzohet në mënyrë aktive, sepse kështu do të përforcohet bashkëpunimi mes prindërve dhe edukatores. Pra, në këtë mënyrë mundësohet zhvillimi i një bashkëpunimi të sigurtë, pa paragjykime, me plot respekt e i gjallë, i cili, në fund të fundit, është në interes dhe në të mirë të të gjithëve.

Rëndësia e institucioneve për fëmijët e vegjël

Përpos familjes, për zhvillimin gjuhësor, intelektual, motorik dhe social të fëmijës rol të veçantë luajnë institucionet parashkollore. Këto janë të rëndësishme për të gjithë fëmijët, pavarësisht faktit nëse prindërit kanë mundësi t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre që ta mësojnë gjuhën amtare dhe gjuhën e rrethit ku jetojnë, p.sh. frëngjishten, gjermanishten, italishten etj.

Në raste optimale prindërit dhe institucionet parashkollore ndikojnë në të mësuarit e njëkohshëm paralel të dy apo më tepër gjuhëve dhe të normave kulturore, të cilat ndikojnë pozitivisht në integrimin dhe në zhvillimin e fëmijës. Këto institucione i përkrahin prindërit, roli i të cilëve, megjithatë, mbetet qendror.

Me rëndësi të madhe janë institucionet jashtëfamiljare, sepse fëmijët e moshës së re mësojnë shpejt dhe i formojnë kompetencat e tyre themelore, siç janë: perceptimi, fantazia, të menduarit, afërsia sociale si dhe shkathtësia trupore.

Pra, çerdhja dhe grupi i lojës, të cilat do t'i paraqesim më poshtë, janë faktorë vendimtarë për fazat e mëvonshme të të mësuarit, qoftë të gjuhëve, qoftë në përgjithësi.

Ç'janë grupet e lojërave për fëmijë dhe ç'ofrojnë ato?

Edukatorja e një grupi lojërash për fëmijë përkujdeset për tetë deri në dymbëdhjetë fëmijë, nga mosha tre-deri pesë vjeç. Këto grupe lojërash zhvillohen 1-2 herë në javë, nga dy deri në tri orë. Në këto grupe lojërash, fëmija gjen lojëra të ndryshme, të cilat ndoshta nuk mund t'i ketë në shtëpi. Në grupin e lojës fëmija merret me aktivitete dhe me lojëra të ndryshme, të cilat ndihmojnë të mësuarit e gjuhës lokale, si, për shembull: frëngjisht, italisht, gjermanisht etj. Në grup fëmija këndon, vallëzon, luan lojëra lëvizëse dhe gjuhësore. Kështu, mund të shtohet interesimi i fëmijës për të mësuar gjëra të reja dhe ai e begaton fondin e fjalëve. Edukatorja përkujdeset për fëmijën dhe e përkrah atë që të komunikojë në gjuhën lokale. Ajo me fëmijën shikon libra për fëmijë, luan të mbajturit mend dhe përsërit fjalë të ndryshme, me qëllim që ato t'i përforcojë në fjalorin e tij. Edhe gjatë pikturimit, vizatimit me ngjyra etj., edukatorja kujdeset që fëmija të përsërisë fjalë të mësuara më parë, të cilat tash do drejtpërdrejt t'i lidhë me gjësendet që i sheh, i nuhat, i prek etj. Aftësitë që i përfiton fëmija në grupin lojës, e përgatisin atë për të kaluar pa vështirësi gjuhësore dhe sociale në entet parashkollore.

Ç'janë çerdhet dhe ç'ofrojnë ato?

Një edukatore e specializuar për fëmijë të vegjël mund të kujdeset për tetë deri në dhjetë fëmijë të vegjël nga mosha dymujore deri në moshën gjashtë vjeç. Fëmijët mund të shkojnë në çerdhe prej një gjysmë dite deri në pesë ditë në javë. Në qoftë se prindërit punojnë, fëmija në çerdhe do të ketë një përkujdesje të mirë.

Ç'janë familjet ditore dhe ç'ofrojnë ato?

Në familjen ditore përkujdesja për fëmijën është e ngjashme sikur në shtëpi. Familjet ditore edhe janë vetë prindër dhe kanë fëmijë të moshës së njëjtë. Fëmija mund të luajë i lirë me fëmijët e familjes ditore. Prindërit caktojnë orarin e përkujdesjes për fëmijën sipas dëshirës dhe mundësive.



© Rexhep Rifati

«Rol të rëndësishëm në të mësuarit e gjuhës së dytë (frënge, gjermane, italiane, retoromane etj.) luajnë edhe njohuritë e fëmijës në gjuhën amtare. Këtë situatë heterogjene të fëmijës duhet ta kenë parasysh prindërit dhe edukatorja.»



Përgatitja e fëmijës para se të shkojë në çerdhe apo në grup të lojës

Në ditët apo javët e para në çerdhe ose në grup të lojës fëmija mund të ketë vështirësi me mjedisin e ri. Ai është mësuar që gjithmonë të jetë pranë nënës së tij dhe e ka të vështirë të ndahet prej saj. Një faktor tjetër është mungesa e gjuhës lokale. Mirëpo, kjo situatë nuk zgjat shumë, sepse fëmija shpejt gjen shokë dhe shoqe me të cilët fillon të luajë.

Kalimi i fëmijës prej familjes në çerdhe ose në grup të lojës paraqet, pra, një ndryshim mjedisi. Për prindërit gjatë fazës së parë ndoshta është vështirë ta lënë fëmijën në çerdhe ose në grupin e lojës duke qarë. Disa prindër brengosen dhe ndiejnë keqardhje kur e zgjojnë fëmijën në mëngjes në vend se ta lënë të flejë sa të dojë. Një numër prindërisht për herë të parë përjetojnë diçka që nuk e kanë praktikuar kurrë në vendlindje. Ata mendojnë se janë duke i dhënë fëmijës obligime që në moshë foshnjore. Pavarësisht kësaj bindjeje, fëmija që shkon në çerdhe apo në grup të lojës ka shumë përparësi, qoftë për sa i përket gjuhës, qoftë për sa u përket sjelljeve shoqërore. Përpos kësaj, ai ndihet i lumtur dhe do të ketë vetësiguri kur të shkojë në ente parashkollore.

Ndikimi i edukatores mbi zhvillimin dhe sjelljen e fëmijës

Edukatorja, me bindjen e saj ndaj gjuhës amtare të fëmijës, mund të ndikojë në zhvillimin gjuhësor, kulturor dhe në sjelljen e tij. Pra, ajo mund të ndikojë në mënyrë motivuese, duke qenë e vetëdijshme për rolin që ka si shembull për fëmijën, i cili gjatë lojës e imiton edukatoren. Faktorët, si: motivimi, qëndrimi pozitiv ndaj situatës gjuhësore dhe veçantive individuale të fëmijës, mund të ndikojnë pozitivisht mbi gjuhën. Ky lloj motivimi njëkohësisht paraqet nevojë për fëmijën që të identifikohet me kulturën dhe me gjuhën lokale.

Rol të rëndësishëm në të mësuarit e gjuhës së dytë (frënge, gjermane, italiane, retoromane etj.) luajnë edhe njohuritë e fëmijës në gjuhën amtare. Këtë situatë heterogjene të fëmijës duhet ta kenë parasysh prindërit dhe edukatorja. Për prindërit është me rëndësi që me fëmijën sa më shumë të komunikojnë në gjuhën amtare dhe gjatë komunikimit të flasin ngadalë, duke mos përdorur gjuhë të cinguar, por fjalë të plota dhe të llojlojshme. Që të ketë fëmija kontakt të hershëm me gjuhën amtare standarde, rekomandohet që të ndjekë kurse në gjuhën amtare. Kështu, fëmija do të arrijë të ketë vetësiguri, si në gjuhën amtare ashtu edhe në atë të vendit ku rritet.

Forma dhe situata të tjera të vlefshme për ta mësuar gjuhën

Përrallat, gjëegjëzat, tregimet etj. përmbajnë një sërë figurash, të cilat fëmija i adhuron. Gjatë rrëfimit fëmija shpesh thellohet e futet në rolin e ndonjërës nga figurat, pra në botën e përrallave dhe kështu zhvillon veprimtarinë e tij gjuhësore. Fëmija automatikisht tregon solidaritet ndaj ndonjë figure që i pëlqen dhe përpiqet ta ndihmojë, nëse ajo gjendet në situatë të pavolitshme ose në rrezik. Kështu fëmija i zhvillon kompetencat e tij sociale. Sidomos për fëmijët e vegjël, përrallat dhe tregimet janë mahnitëse, sepse ato e kënaqin dhe e shtyjnë të qeshë. Dialogët e ndryshëm ndërmjet prindërve dhe fëmijës janë një formë tjetër përkrahëse për zhvillimin gjuhësor dhe social të tij.

Prindërit nga vendlindja sjellin një thesar dhe traditë të begatë rrëfyese. Ky thesar i ndihmon fëmijës, sepse në këto përralla tradicionale gojore, në vjersha dhe në këngë gjuha shprehet në mënyrë të larmishme dhe tërheqëse për fëmijën. Ky thesar i begatë duhet të ruhet dhe t'i bartet fëmijës që rritet në diasporë.

Ushqimi me cilësi të lartë

Sasia e madhe e mallrave ushqimore ua bën prindërve gati të pamundur ta ushqejnë fëmijën vetëm me ushqim të shëndoshë. Megjithatë, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar sa më mirë, fëmija ka nevojë të ushqehet me masë dhe në orar të caktuar, të pijë rregullisht lëngje dhe të bëjë lëvizje:

- pesë shujta në ditë: mëngjes, diçka të vogël paradite, drekë, përsëri diçka të vogël pasdite dhe darkë. Po aq me rëndësi është që prindërit dhe fëmija gjatë shujtës kryesore të mblidhen së bashku rreth tavolinës dhe të shkëmbejnë mendime. Për të mos e shpërqendruar fëmija vëmendjen gjatë bisedës në tavolinë, rekomandohet që të mbyllet televizori. Gjellët me shumë yndyrë e me shumë kripë dhe ëmbëlsirat pa masë nuk janë të këshillueshme. Pemët dhe perimet, specialitetet që bëhen prej brumit, patatet dhe orizi paraqesin bazën solide për një ushqim të shëndetshëm. Prodhimet e qumështit, siç janë: djathi, kosi, gjalpi etj., janë të domosdoshme për fëmijën;
- fëmija po ashtu rregullisht duhet të pijë ujë natyror, pa gaz ose me gaz, çaj lulesh ose frutash, qumësht, por assesi lëngje që përmbajnë sheqer, si, për shembull, kokakolë, limonadë etj. Këto pije përmbajnë shumë sheqer, andaj janë të dëmshme për dhëmbët dhe ndikojnë negativisht mbi përqendrimin dhe gjumin e fëmijës;
- fëmija ka nevojë për lëvizje. Nëse bën lëvizje të mjaftueshme gjatë ditës, atëherë do ta marrë gjumi më lehtë dhe do të flejë më gjatë. Prandaj, është tepër me rëndësi që prindërit të shkojnë me fëmijën në pishinë, të luajnë me të në vende të përshtatshme për fëmijë ose të dalin të shëtisin në natyrë. Aktivitetet e këtilla ndikojnë pozitivisht në zhvillimin fizik dhe psikik të fëmijës, prandaj duhet të praktikohen në mënyrë të rregullt. Njëkohësisht duhet të shmangen lojërat kompjuterike, të cilat nuk ofrojnë interaksion, por, përkundrazi, mund të nxisin sjellje agresive tek fëmija.

Gjumi dhe ritmi i të fjeturit

Fëmija që fle mirë, ndihet i kënaqur dhe zhvillohet mirë. Sipas ekspertëve, fëmija deri në moshën katër vjeç zakonisht ka nevojë të flejë 1 - 2 orë pasdreke.

Natyrisht që gjumi është çështje individuale dhe ka fëmijë të cilët që nga mosha dy vjeç nuk flenë në mesditë. Megjithatë, fëmijës së moshës një deri katër vjeç i nevojiten midis dymbëdhjetë (në moshën katër vjeç) dhe gjashtëmbëdhjetë orë gjumë (në moshën një vjeç).

Fëmija që nuk bën gjumë të mjaftueshëm, ndër të tjera, është i rrezikuar të ketë mbipeshë.



Për më shumë informacione



http://www.vd.ch/fileadmin/user_upload/organisation/dire/spop/coordination_integration/fichiers_pdf/Brochure_Bienvenue_5e_ed_ALB.pdf




<http://www.vd.ch/themes/vie-privee/population-etrangere/integration-et-prevention-du-racisme/brochure-contacts/>

Për më shumë informacione



http://www.vd.ch/fileadmin/user_upload/organisation/dfj/dgeo/fichiers_pdf/DP_Evaluation_AL_2011.pdf



http://www.vd.ch/fileadmin/user_upload/organisation/dfj/spj/fichiers_pdf/Vademecum_AMF_albanais_web_110901.pdf

Për më shumë informacione



<http://www.iseal.ch>



<http://www1.lausanne.ch/ville-officielle/administration/sports-integration-et-protection-population/service-administratif-et-integration/bureau-pour-integration-des-immigres.html>



ISEAL

Institut Suisse d'Etudes Albanaises
Istituto Svizzero per gli Studi albanesi
Instituti Zviceran i studimeve shqiptare
Schweizerisches Institut für albanische Studien







www.iseal.ch